



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 27 / 11 Prot

Vlorë, më 21 . 12 . 2021.

VENDIM

Nr.4, datë 09.12.2021

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR
NËNTOKËSOR PËR UJË TË PIJSHËM TË BASHKISË HIMARË, ME
VENDNDODHJE, BASHKIA HIMARË, QARKU VLORË**



Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje, për përdorimin e burimit ujor nëntokësor për ujë të pijshëm të Bashkisë Himarë me vendodhje: Bashkia Himarë, Qarku Vlorë.
2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Burimi i Lepushës
Vendodhja e burimit ujor (KRGJSH)
X= 487427.26;
Y= 4451205.09;
Z=519 m.m.n.d

Sasia e ujit të kërkuar Q= 139.10 l/s
Prurja mesatare vjetore Qmes=104.6 l/s

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

K R Y E T A R I

FLAMUR MAMAJ

